

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 37041/17
Kudret KOPO kundër Shqipërisë
dhe 2 kërkesa të tjera
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 13 qershor 2024 si një Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *Kryetar,*

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë kërkesat e mësipërme të depozituara në data të ndryshme të paraqitura në tabelën bashkëlidhur,

Duke mbajtur në konsideratë deklaratat e paraqitura nga Qeveria e paditur me anë të të cilave i kërkonte Gjykatës të hiqte çështjet nga lista e çështjeve,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkesve është paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

Ankesat e kërkesve bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me mosekzekutimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve të brendshme iu komunikuan Qeverisë Shqiptare (“Qeveria”). Edhe në kërkesat nr. 42612/19 dhe 41365/21, u komunikuan ankesa mbështetur në të njëjtat fakte sipas parashikimeve të tjera të Konventës.

LIGJI

Duke marrë në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata e gjykon me vend t’i shqyrtojë ato së bashku në një gjykim të vetëm.

Pas negociatave të pasuksesshme për zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën se Qeveria propozonte të bënte deklaratat të njëanshme me qëllimin për të zgjidhur problematikat e ngritura në këto ankesa. Në vijim, Qeveria i kërkoi Gjykatës që t’i përjashtonte kërkesat sipas nenit 37 të Konventës.

Qeveria pranoi shkeljen e Konventës për sa i përket procedurave të tejzgjatura për ekzekutimin e vendimit si edhe mungesës së një mjeti efektiv vendas në atë periudhë për t’u ankuar.

Qeveria ofroi t’u paguante kërkesve shumat e detajuara në tabelën bashkëlidhur dhe ftoi Gjykatën t’i hiqte kërkesat nga lista e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës. Shumat do të konvertoheshin në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes dhe do të duhej të paguheshin brenda tre muajve nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës. Në rast të mosshlyerjes së këtyre shumave brenda periudhës tremujore të përmendur më sipër, Qeveria ndërmerre të paguante interes të thjeshtë ndaj shumave nga përfundimi i periudhës tremujore deri në momentin e shlyerjes në një normë të barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre pikë përqindje. Në kërkesën nr. 41365/21, Qeveria deklaroi se do të merrte përsipër të siguronte ekzekutimin e vendimeve vendase konkrete në këtë çështje brenda së njëjtës periudhë tremujore, si edhe të paguante çdo kosto të procedurave

vendase për ekzekutimin. Shlyerja e pagesës dhe ekzekutimi i vendimeve të brendshme për çështjen konkrete do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

Kërkesve iu dërguan kushtet e deklaramëve të njëanshme të Qeverisë disa javë përpara këtij vendimi. Të tre kërkesit i refuzuan kushtet e ofruara nga Qeveria në deklaramet e saj.

Gjykata nënvizon se neni 37 § 1 (c) ia mundëson heqjen e një çështjeje nga lista e saj e çështjeve nëse:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”.

Në këtë mënyrë, ajo mund të heqë kërkesa në mbështetje të nenit 37 për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës 1 (c) sipas një deklarate të njëanshme nga një Qeveri e paditur edhe nëse kërkesit dëshirojnë që të vijohet me shqyrtimin e çështjeve (shih, veçanërisht, *Tahsin Acar kundër Turqisë*, vendim (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75-77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar një praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me mosekzekutimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve të brendshme (shih, për shembull, *Qufaj Co Sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, 18 nëntor 2004, dhe *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 Shtator 2009).

Duke pasur në konsideratë pohimet në deklaramet e Qeverisë si edhe shumën e kompensimit të propozuar – e cila është në pajtueshmëri me shumat e akorduara në çështje të ngjashme – Gjykata vlerëson se nuk është e justifikueshme që të vijohet me shqyrtimin e kërkesave (neni 37 § 1 (c)).

Mbështetur në sa më sipër, sipas përcaktimit për të drejtat e njeriut në Konventë dhe Protokolleve të saj Gjykatës nuk i kërkohet që të vijojë me shqyrtimin e kërkesave (neni 37 § 1 *in fine*).

Përfundimisht, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk respekton kushtet e deklaramëve të saj të njëanshme, kërkesat mund të rikthehen në listë në përputhje me nenin 37 § 2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Për sa më sipër, është me vend që çështjet të hiqen nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos t'i bashkojë kërkesat;

Mban në konsideratë kushtet në deklaramet e Qeverisë së paditur dhe angazhimet për të garantuar përmbushjen e masave të referuara në këto deklaramet;

Vendos t'i heqë kërkesat nga lista e saj e çështjeve sipas nenit 37 § 1 (c) të Konventës.

.Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 4 korrik 2024.

Viktoriya Maradudina
Zëvendëssekretare e përkohshme

Peeter Roosma
Kryetar

SHTOJCË

*Lista e kërkesave me anë të të cilave paraqiten ankesa sipas nenit 6 § 1 të Konventës
(mosekzekutimi ose ekzekutimi i vonuar i vendimeve të brendshme)*

Nr.	Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkesit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së komenteve të kërkesit	Shuma e akorduar për dëmin jo pasuror dhe kostot dhe shpenzimet për kërkes (në euro) ¹
-----	----------------------------------	-----------------------------------	--	--	---	--

¹ Plus çdo taksë që mund t'u tarifohet kërkesve.

1	37041/17 17.5.2017	Kudret KOPO 1956		03/11/2023	08/12/2023	3,600
2	42612/19 8.8.2019	Vatnikaj TUNXH 1968	Bianku Ledi Londër	03/11/2023	04/01/2024	2,400
3	41365/21 9.8.2021	Veri SATKA 19961	Sheta Xhevdet Tiranë	03/11/2023	12/12/2023	3,600